

FJALA E DEPUTETIT XHEMAL QEFALIA

E ENJTE 28 PRILL 2022

E nderuar kolege, nuk kemi pse të shqetësohemi që nuk është prezente opozita, sepse ata kanë plane dhe detyra të tjera brenda vetes dhe nuk besoj se paraqesin interes diskutimi për një marrëveshje dhe një projektligj kaq të rëndësishëm. E them shumë të rëndësishëm, pasi ky projektligj ka të bëjë me një investim, i cili është domosdoshmërisht i nevojshëm për të ndërhyrë në hidrocentralin e Fierzës. Ka vite, madje dekada të tëra, që nuk është ndërhyrë në zemrën e sistemit: në turbinat e hidrocentralit të Fierzës.

Këtu kërkohet një hua dhe është rënë dakord që kjo hua të jetë në vlerën e 40 milionë eurove. Faktikisht, zanafillën kjo hua e ka në marrëveshjen e datës 27 janar 2021, kur qeveria federale gjermane dhe qeveria shqiptare nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi financiare. Cili është qëllimi dhe çfarë roli do të ketë ndërhyrja në zemër të sistemit, siç e quajti me të drejtë një specialist, që prezantoi projektligjin në Komisionin e Ligjeve? Qëllimi është të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të vendit, duke siguruar furnizimin me energji për një kohë të gjatë, të qëndrueshme dhe pa impakt në klimë, duke zgjeruar periudhën e shfrytëzimit të HEC-it të Fierzës për të paktën 30 vjet, duke rritur dukshëm eficiencën e tij. Por ju thoni pse hua, pse borxhe! Një kolegu im një javë më parë i përmendi disa shtete, të cilat e kanë rritur nivelin e borxhit në shifra të mëdha, duke filluar nga Japonia me 257%, Italia 159%, Greqia 207%, Spanja 120% e kështu me radhë, pra ashtu si një familje që kërkon borxh për të bërë diçka më shumë.

Borxhin e merr pikërisht nëse bindet në seriozitetin që ka vetë qeveria, që këtë borxh dhe këtë hua do ta përdorë për një qëllim pozitiv: për të mirëmbajtur dhe për të lënë në harresë një vepër kaq të madhe, siç janë lënë vepra të tjera. Koleges që është këtu, po i them: superfosfati i Laçit u shkatërrua, a ta lëmë edhe këtë të kthehet në ngrehinë? Jo, është ndërhyrja e qeverisë shqiptare, e cila e ka edhe në strategjinë e saj kombëtare si një projekt, i cili kontribuon drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivit për rritjen e furnizimit me energji elektrike në veçanti, duke e bërë pjesë aktive të tregut rajonal energjetik dhe duke përmirësuar eficiencën e saj energjetike. Nuk po ndalem te shumë vepra të tjera, të cilat ndihmojnë situatën e rëndë të krizës energjetike edhe nga pasojat e luftës në Ukrainë, por doja ta veçoja dukshëm ndërhyrjen që do të bëhet në hidrocentralin e Skavicës, një vepër e stërmadhe e planifikuar

shumë e shumë vite më parë dhe do të jetë kjo qeveri, e cila do të realizojë, siç ka realizuar mjaft projekte të mëdha, të cilat janë prezente.

Nuk po i listoj, sepse janë shumë, por dukshëm qytetarët i dinë. Si qytetar i Tiranës e di shumë mirë investimin e madh që u bë tek Unaza, por di edhe Unazën e Madhe që po merr jetë, siç është bërë edhe investimi në Rrugën e Arbrit, në tunelin e Llogorasë, në Skavicë, në portin e Durrësit etj. Doja ta mbyllja me një batutë, në qoftë se do të quhet kështu: si deputet i Tiranës dhe banor i saj më kujtohet që, kur ishin në qeveri këta që nuk janë këtu, Kryeministri përuroi diku në një zonë në periferi të Tiranës një nënstacion elektrik dhe, të themi të drejtën, ne si qytetarë të saj u gëzuam që së fundi do të ketë drita Tirana, por, në fakt, jo që nuk pati drita, por patëm një javë ndërprerje të energjisë elektrike dhe njerëzit thoshin se Kryeministri, në vend që të presë shiritin, kishte prerë kabllon.

Ndaj, të nderuar kolegë, ju ftoj ta votoni këtë projektligj, pasi kjo i shërben interesit të përgjithshëm, i shërben përmirësimit të rrjetit të energjisë dhe shpresoj që, edhe pse nuk janë këtu, deputetët e opozitës do ta votojnë këtë, si një ndihmë që i vjen sistemit. Faleminderit!